

AUTORITETI PORTUAL DURRËS NË EKSPO-KONFERENCËN “SHQIPËRIA NJË DESTINACION PËR INVESTIME”

-Dy ditë radhazi në Pallatin e Kongreseve në Tiranë-

Porti Detar i Durrësit është paraqitur më 11 dhe 12 maj në edicionin e dytë të Ekspo-Konferencës “Shqipëria një destinacion për investime”, organizuar nga FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj), METE (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës) dhe MPPT (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Në Ekspokonferencën **“SHQIPËRIA NJË DESTINACION PËR INVESTIME”** marrën pjesë me panelin e tyre prezantues dhe ekspozues Sektorë prioritarë të ekonomisë shqiptare si Energjitika, ai i Burimeve Minerale, Sektori i Naftës dhe Gazit dhe ai i Infrastrukturës,

Në kuadër të Sektorit të Infrastrukturës në këtë panair-konferencë u prezantua edhe Autoriteti Portual Durrës, që synon nxitjen e bashkëpunimeve reciproke me Investitorë vendas dhe të Huaj; shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e bashkëpunimeve të mëtejshme si dhe vendosjen e pikave të kontaktit me biznesmenët pjesmarrës në ekspokonferencë.

Nisma e organizatorëve ka si qëllim promovimin e burimeve natyrore dhe njerëzore në një ekspozitë gjithëpërfshirëse që ofron Investitorët dhe Tregtarët vendas dhe të huaj që të zhvillojnë bizneset e tyre në Shqipëri.



